



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

AKTIVITET E ZHVILLUARA NË SEKTORIN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL GJATË MUAJIT NËNTOR 2022

- ❖ Shqyrtimi i kërkesave në intranet
- ❖ Pjesëmarrje në komisione të ndryshme dhe vizita në teren.
- ❖ Shqyrtimi i kërkesave për dëme në bujqësi, procedimi i listës me raporte për gjithsej 475 fermerë në vlerë prej 1,552,100.00euro.
- ❖ Vizita në teren për aplikuesit për motokultivator nga marrëveshja e bashkëpunimit me “Qatar Charity”.
- ❖ Pagesa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
- ❖ Regjistrimi i fermerëve të rinjë, dhe paisja me NIF sipas kërkesave të fermerëve
- ❖ Informata dhe këshilla të vazhdueshme për fermerë sipas kërkesave të tyre.
- ❖ Kompletimi i dokumentacionit të fermerëve aplikues për mjedra nga programi i pagesave direkte për vitin 2022 dhe përcjellja e tyre në MBPZHR.

AKTIVITET E ZHVILLUARA NË SEKTORIN E PYLLTARISË GJATË MUAJIT NËNTOR 2022

- ❖ Vlerësimi i dëmeve pyjore të shkaktuara në prona private sipas kërkesës së njësisë hetimore. (1 rast).
- ❖ Realizimi i konfiskimeve të masës drusore në sasi prej 14.82 m³ dru zjarri.
- ❖ Pranimi i gjithsej 7 fletëparaqitjeve kundërvajtëse me vëllim prej 9.58 m³ dhe vlerë monetare 1480.92euro, të cilat janë përcjellur në Gjykatën Kundërvajtëse.

- ❖ Përfundimi i revizionit pyjore në REP Sllatinë si dhe vazhdimi i revizionit në REP Llapashticë me qëllim të konstatimit dhe regjistrimit të gjendjes ekzistuese sa i përket dëmeve pyjore.
- ❖ Pranimi i gjithsej 71 aktvendimeve, prej të cilave 68 janë kundërvajtëse me vëllim prej 104.47 m³ dhe vlerë 12675.10euro, ndërsa 3 janë penale me vëllim prej 9.21m³ dhe vlerë 1247 euro.
- ❖ Pranimi i gjithsej 3 kërkesave për leje për prerje në pyje private të cilat janë dërguar në DKR të APK-së për shqyrtim, ndërsa janë paisur 3 pronarë të pyjeve private me leje për prerje pylli me ç'rast të hyrat nga shërbimet në pyje private janë 270.93euro.
- ❖ Nënshkrimi i kontratës për shitjen e masës drusore-dru teknik që ndodhet e deponuar në depon e fshatit Peran.
- ❖ Nënshkrimi i dy kontratave për shitjen e masës drusore në ngastrën 167-02 NJM Popovë-Llapashticë dhe ngastrën 234-02 NJM Popovë-Llapashticë.
- ❖ Vazhdimi i punimeve në ngastrën 063-Pjesa e dytë për prerje selektive, sipas udhëzimeve të inxhinierëve të APK-së.
- ❖ Raportimi i rregulltë në baza mujore në DKR të APK-së lidhur me gjendjen e pylltarisë në Komunën tonë.
- ❖ Pjesëmarrje në komisione dhe vlerësime të ndryshme
- ❖ Realizimi i kontrollave të rregullta nga zyrtarët e pylltarisë në Rajone Ekonomike Pyjore.

Podujevë

Nr. 12-320/01-0100131/22

06 Dhjetor 2022

Drejtori

Fatmir Rudari



Fatmir Rudari